



Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), lidhur me nenin 14, dhe 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, e në mbështetje të nenit 19, paragrafi 3, pika 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr-06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, publikuar në “Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 10/2019” e konform nenit 22, të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe neneve 15, 29, pika 2, të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datë, -----, miraton këtë:

Projekt-V E N D I M

Neni 1

1. Me këtë vendim firmës **“Ben Center” SH.P.K & “Ada Group” SH.A** me seli në Rr. “Xhavit Bajraktari” në Suharekë të cilat i përfaqëson **Elona KUÇI**, nga Suhareka; **I jepen** në shfrytëzim afatgjatë deri **99, (nëntëdhjetë e nëntë)** vite, pronat e paluajtshme, pasuri shoqërore në emër të Komunës së Suharekës, në **“Zonën industriale”** në Shirokë, **për ushtrim të veprimtarisë afariste**, sipas rekomandimit 01-Nr-016-32946 të datës 02.06.2022, të komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, parcelat si më poshtë;
 - 1.1 **Parcela** kadastrale, **P-72116046-02785/81** zona kadastrale Suharekë me sipërfaqe prej: **4500m²**, me destinim sipas planit rregullativ urban të zonës Industriale në Shirokë **“Përpunimi i produkteve ushqimore”**, e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komuna e Suharekës.
 - 1.2 **Parcela** kadastrale, **P-72116046-02785/82** zona kadastrale Suharekë me sipërfaqe prej: **4490m²**, me destinim sipas planit rregullativ urban të zonës Industriale në Shirokë **“Përpunimi i produkteve ushqimore”**, e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komuna e Suharekës.
 - 1.3 **Parcela** kadastrale, **P-72116046-02785/83** zona kadastrale Suharekë me sipërfaqe prej **2747m²**, me destinim sipas planit rregullativ urban të zonës Industriale në Shirokë **“Përpunimi i produkteve ushqimore”**, e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komuna e Suharekës.
 - 1.4 **Parcela** kadastrale, **P-72116046-02785/84** zona kadastrale Suharekë me sipërfaqe prej: **3990m²**, me destinim sipas planit rregullativ urban të zonës Industriale në Shirokë **“Përpunimi i produkteve ushqimore”**, e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Komuna e Suharekës.

Neni 2

Afati për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme fillon të rrjedh nga data, **00.06.2022** dhe përfundon afati më datën, **00.06.2121**, pas mbarimit të këtij afati ose ndërprerjes së parakohshme të kontratës e drejta e shfrytëzimit i kthehet Komunës së Suharekës si titullar faktik dhe juridik.

Neni 3

3.1 Obligohet; Kryetari i Komunës që me **personin fizik dhe juridik përfitues të pronës së paluajtshme të Komunës**, të lidh kontratë me të cilën i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve kontraktuese.

3.2. Obligohen; përfituesi i pronave të paluajtshme të Komunës, konkretisht personi fizikë dhe juridikë të cekur në neni 1, të këtij vendimi, që në afat prej 10, (dhjetë) dite nga data e miratimit të këtij vendimi të sjellin garancionin bankar ose sigurimin nga kompanitë e sigurimeve të licencuar në Republikën e Kosovës dhe atë 10% të vlerës së propozuar investive.

3.3 Nëse personat e cekur në paragrafin 2, të nenit 3, të këtij vendimi nuk e sjellin dokumentacionin e kërkuar në afatin ligjor, konsiderohet se ka hequr dorë nga shfrytëzimi i pronës së paluajtshme.

Neni 4

4.1 Obligohen shfrytëzuesit e cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi, që **pronën e paluajtshme** të cekur në nenin 1, të këtë vendim, ta shfrytëzojnë me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

4.2 Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
Më datë_____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr. ec Bexhet KUÇI